REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 979/20
Datë/Datum. 20.11.20
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: KEK-20-1944-1-2-1

Sa i përket tenderit për Furnizim me pjese ndërrimi për mekanizimin ne DPQ

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

PRISHTINA AUTO LLC
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Qendra Tregtare Përballë KEDS, Kroi i bardhë, Lokali NR. 14
(Adresa)

Prishtinë
(Vendi)

10000
(Kodi postar)

049/120-182
(Numri Telefonit)

N/A
(Numri i Faks-it)

SHQIPE GASHI
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

Sh.gashi@prishtina-auto.com
(Adresa elektronike)

19/11/2020
(Data e parashtrimit të ankesës)

PRISHTINA AUTO L.L.C. NRB: 712042 NRF: 601526976 info@prishtina-auto.com

(Nënshkrimi dhe vula)

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës" "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit", apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës:

Njoftimi për kontratë është publikuar me datë 14/05/2020 ndërsa afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë data 03/06/2020 ora 12:00. Njoftimi për vendimin e AK-së dhe letren standarte për tenderuesin e suksesshëm është publikuar me datë 08/07/2020 në sistemin e e-prokurimit. Kriteri për dhënie të kontrates është ÇMIMI MË I ULËT. AK ka shpall fitues për LOT II kompaninë me çmim më të ulët PRISHTINA AUTO L.L.C me çmim total të ofertës 6.881,12 Euro.

Meqenëse Kompanisë tonë i është mohuar padrejtësisht dhënia dhe nënshkrimi i kontratës si dhe padrejtësisht është eliminuar nga aktiviteti tenderik në fjalë nga AK KEK, ne si OE i kemi shpreh padrejtësitë, pakënaqësitë dhe shqetësimet tona rreth vendimit të AK-së duke parashtruar me datë 16/07/2020 kërkesë për rishqyrtim të rastit në fjalë. E njejta kërkesë për rishqyrtim është hudhur poshtë si e pabazuar nga AK duke mos dhënë arsyetime se përse kërkesa jonë është e pabazuar. Ne si OE, me datë 28/07/2020 kemi parashtruar ankesë në OSHP me numër të PSH 512/20. OSHP me datë 04/09/2020 ka aprovu ankesën tonë si të bazuar.

AK e ka publikuar në sistemin e-prokurimi njoftimin per vendimin e AK-së me datë 10/11/2020.
OE Prishtina Auto LLC ka bërë kërkesë për rishqyrtim me datë 11/11/2020.
AK e ka publikuar në e-prokurimi përgjigje ndaj kërkesës për rishqyrtim me datë 17/11/2020.
OE Prishtina Auto LLC do të dërgojë për herë të dytë lëndën në OSHP me datë 19/11/2020.

NRB: 71204251
NRF: 601526976

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐ **Jo** ☒

Raportin e hapjes te tenderit e kemi pranuar përmes sistemit të e-prokurimit.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☐ ***Jo*** ☒

Vërejtje: Për çdo njoftim rreth këtij aktiviteti, jemi njoftuar përmes sistemit e-prokurimi!

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒ **Jo** ☐

Kërkesë për rishqyrtim pranë AK kemi bërë me datë 11/11/2020 ndërsa AK ka publikuar në e-prokurimi përgjigjen ndaj kërkesës për rishqyrtim me datë 17/11/2020.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

NENI 7 - Barazia në Trajtim/Jo-Diskriminimi **Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve** **Neni 60 - Kriteret për Dhënien e Kontratës** **NENI 31 nën NENI 31.4** - RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK NENI 31. VALIDITETI I TENDERIT nën Neni 31.4 **VENDIMI I OSHP-SË ME NUMËR 884/14 Pika 1 dhe 2.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë e rrejshme ose mashtruese.*

KOSHTINA AUTO L.L.C
NRF: 601526976

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Bazuar në njoftimin për vendimin e AK-së i datës 10/11/2020, marrë parasysh arsyetimin pa bazë të AK-së, konfirmojmë se i njëjti ka bërë shkelje të Nenit 31 nën Neni 31.4 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik si dhe vendimi i OSHP-së me numër 884/14 Pika 1 dhe 2 që i obligon AK të kërkojë me shkrim zgjatjen e validitetit të tenderit dhe atë **duhet të kërkohet para datës së skadimit**. AK nuk e ka respektuar këtë procedurë dhe si pasojë AK ka kërkuar nga OE Prishtina Auto LLC zgjatjen e validitetit të ofertë **18 ditë PAS datës së skadimit.** Si dëshmi për shqyrtim, e gjeni të bashkangjitur në lëndën tonë dokumentin me format .pdf me emërtim Kerkese per vazhdim të validitetit të ofertës - LOT 2 i ngarkuar nga AK në sistemin e-prokurimi me datë 19/08/2020 ora: 12:49 dhe aty AK deklaron si në vijim:

"Me datën 01.08.2020 i ka kaluar vlefshmëria ofertën tuaj, ne kërkojmë që nga data 02.08.2020 deri më datën 30.09.2020 të vazhdoni vlefshmërinë e ofertës tuaj për të vazhduar më tej deri në vendimin përfundimtar", "Ne presim një përgjigje nga ana juaj deri në datën 19.08.2020. në ora 12:00". Nga kjo e cekur nga AK, dëshmojmë se i njëjti ka bërë shkelje Nenit 31 nën Neni 31.4 të rregullave dhe udhëzuesit operativ për prokurimin publik si dhe vendimi i OSHP-së me numër 884/14 Pika 1 dhe 2, sepse nuk e ka kërku zgjatjen e validitetit të ofertë ashtu siç rregullorja dhe LPP e urdhëron, pra nuk e ka kërkuar një dokument të tillë nga ne **"PARA"** datës së skadimit të vlefshmërisë të ofertës por përkundër kësaj, të njëjtin dokument e ka kërkuar **"PAS (18 Ditë)".** Në bazë të kërkesës së AK-së për përgjigje nga ana jonë deri me datën e cekur nga AK që është 19/08/2020, në ora 12:00, ne nuk e kemi të kjartë se si është mundësia t'i përgjigjemi kësaj shkrese kur e njejta është publikuar në sistemin e-prokurimi ditën e njëjtë 19/08/2020, në ora 12:49. Nga kjo nënkuptojmë që AK e ka publiku kërkesën në ora 12:49 ndërsa kërkon nga ne si OE që t'i përgjigjemi në të njëjtën ditë në ora 12:00.

Poashtu arsyetimi i AK-së në vendimin për refuzim të kërkesës tonë për rishqyrtim i datës 17/11/2020 që deklaron se kanë qenë me staf të reduktuar dhe bartësi i këtij aktiviteti ka qenë i infektuar dhe kohë të gjatë nuk ka qenë në punë dhe si pasojë e kësaj ka rrjedh ky gabim është i pabazuar dhe në kundërshtim të plotë me pikën 2 të vendimit të OSHP-së i datës 25/11/2014 me numër 884/14 që specifikon si në vijim:

"Në rast se zyrtarët e prokurimit nuk veprojnë konformë nenit 28.4 të UOPP-së, atëherë autoriteti kontraktues, ***nuk mund të bëjë anulimin e tenderit për shkak të skadimit të validitetit të ofertave dhe skadimit të sigurimit të tenderit, por janë të obliguar që rishtas të iu dërgojnë kërkesën për vazhdim të validitetit të ofertave dhe të tenderit të gjithë operatorëve ekonomik pjesëmarrës që kanë interes material në aktivitet përkatës të prokurimit. Sepse nuk mund të pësojnë dëme operatorët ekonomik, për faj dhe neglizhencë të autoriteteve kontraktuese****. Anulimi i tenderëve me pretekst të skadimit të validitetit të ofertave që fatkeqësisht ka filluar të bëhet praktik nga disa autoritete kontraktuese dhe është në kundërshtim me parimin e ekonomicitetit dhe efikasitetit në prokurimin publik".*

Ne deklarojmë se AK duke e anashkaluar plotësisht vendimin e OSHP-së i datës 04/09/20 me numër të protokolit 512/20, po tenton në vazhdimësi të dëmtojë Operatorin Ekonomik Prishtina Auto LLC që ka dal me çmim më të ulët në këtë aktivitet tenderik bazuar proces verbalit të hapjës së tenderëve që ka ndodh me datë 03/06/2020.

Nuk pranojmë diskriminim dhe trajtim jo profesional dhe jo korrekt nga AK dhe nuk pranojmë që si rezultat i fajit dhe neglizhencës të vazhdueshëm të na shkaktoni padrejtësi dhe dëme të mëdha materiale sepse këto dukuri negative nuk i lejon të praktikohen LPP-ja dhe rregulloret në fuqi. AK ka bërë shkelje të Nenit 60 të LPP-së sepse nuk e ka respektuar kriterin e vetshpallur që është "ÇMIMI MË I ULËT". AK poashtu ka bërë çdo çast shkelje të Nenit 7 sepse vazhdimisht na ka diskriminu duke tentuar me çdo kusht të na eliminojë pa të drejtë nga ky aktivitet tenderik.

Duke potencuar gjithesesi edhe Nenin 59 që ka qenë cak i shkeljes nga AK që nga fillimi i aktivitetit tenderik ne deklarojmë se AK asnjëherë nuk e ka vlerësuar konform LPP dhe rregulloreve në fuqi këtë aktivitet tenderik por vazhdimisht na ka eliminu pa të drejtë duke tentuar që me arsyetime të pabaza të arrijnë një qëllim të tillë të turpshëm.

Ne si Operator Ekonomik i dëmtuar në këtë rast, duke u bazuar në të gjitha pretendimet tona të lartëcekura, kërkojmë nga OSHP për të dytën herë që këtë ankesë të **APROVOJË** si të bazuar dhe lënda të kthehet në **RIVLERËSIM.**

Njëherit kërkojmë nga OSHP që të obligojë AK-në që të respektojë LPP-në dhe rregulloret në fuqi dhe të mos e prolongojë më tepër vlerësimin e kësaj lënde dhe të vijë sa më shpejtë në vendimin e duhur përfundimtar.

NRB: 71203250
NRE: 601526376
info@prishtinaauto.com

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

AK KORPORATA ENERGJETIKE E KOSOVËS në aktivitetin tenderik në fjalë me titull: "Furnizim me pjese ndërrimi për mekanizimin ne DPQ" – LOT2 dhe me numër të prokurimit: "2020/KEK-20-1944-1-2-1/B08-0010432" i ka shkaktu dëme të jashtëzakonshme Operatorit Ekonomik "Prishtina Auto L.L.C." pasiqë për muaj të tërë AK ka anashkaluar mundësinë e shpalljës së vendimit për dhënie të kontratës Kompanisë tonë, përmbushës i Kriterit për dhënie të kontratës "ÇMIMI MË I ULËT" dhe si rezultat hapjës së rrugës për liferim të pjesëve të listuara në DT, Aneksi 1, LOT 2, pjesë të cilat, marrë parasysh situatën e krijuar me Covid-19, për të evituar ndonjë vonësë me liferim të pjesëve nga Anglia dhe Gjermania, bazuar në kushtet e përcaktuara për afatet e liferimit në DT, ne i kemi porositur pjesët dhe ato tanimë kanë mbetur në raftet e Magazinave tona dhe si të tilla nuk e kemi idenë se kujt mundemi të ja shesim, marrë parasysh që janë porositur ekskluzivisht dhe vetëm bazuar në dosjen e tenderit për të cilën po flasim, vetëm pasi që OSHP-ja me vendimin me numër 512/20 i dates 04/09/2020 ka vendosur që ankesa jonë të jetë e bazuar dhe si e tillë është vlerësuar pozitivisht me ç'rast është rekomanduar që aktiviteti tenderik të kthehet në rivlerësim dhe të respektohet në vazhdimësi LPP-ja! Tanimë dëmet neve na janë shkaktuar dhe jemi të detyruar që t'i kërkojmë të drejtat tona që në këto kohëra të vështira ta shpëtojmë Kompaninë tonë nga falimentimi dhe të kalojmë me sa më pak dëme përfshirë këtë situatë kaotike në të cilën ju si AK, respektivisht KEK e keni futur Kompaninë tonë!.

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) *një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
b) *një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
e) *bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,*
f) *Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*
g) *të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*

PRISHTINA AUTO L.L.C.
NRB: 71204251
NRF: 601526976
info@prishtina-auto.com